



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1519/24 Datë: 05/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 126 të mbajtur më datë 22.07.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  - *Master i Mësimdhënies Lëndore MA 120 ECTS, (me 7 specializime) me kuotën maksimumi 175 studentë (nga 25 student për secilin specializim) për vit akademik;*
    1. *Master i Mësimdhënies në Matematikë;*
    2. *Master i Mësimdhënies në Kimi;*
    3. *Master i Mësimdhënies në Biologji ;*
    4. *Master i Mësimdhënies në Histori;*
    5. *Master i Mësimdhënies në Gjeografi;*
    6. *Master i Mësimdhënies në Teknologji dhe TIK;*
    7. *Master i Mësimdhënies në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Faqe 1 nga 2

## ARSYETIM

Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<p><i>Master i Mesimdhënies Lendore MA 120 ECTS</i></p> <p>1. <i>Master i Mësimdhënies në Matematikë;</i></p> <p>2. <i>Master i Mësimdhënies në Kimi;</i></p> <p>3. <i>Master i Mësimdhënies në Biologji ;</i></p> <p>4. <i>Master i Mësimdhënies në Histori;</i></p> <p>5. <i>Master i Mësimdhënies në Gjeografi;</i></p> <p>6. <i>Master i Mësimdhënies në Teknologji dhe TIK;</i></p> <p>7. <i>Master i Mësimdhënies në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.</i></p>	<p>Jehona Ferizi-Miftari</p> <p>Fahri Marevci</p> <p>Arlinda Bytyqi Damoni</p> <p>Zeqir Veselaj</p> <p>Ethem Ceku</p> <p>Tomor Çela</p> <p>Kyvete Shatri</p> <p>Naser Pajaziti</p>

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Master i Mësimdhënies Lendore MA 120 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Juliette Torobian, Milan Pol, Elene Jibladze dhe Domagoj Svirig, është organizuar më 29.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 126-të, të mbajtur më datë 22.07.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë